



HR

Akademia e HR Albania

Cikël trajnimesh 2026



Solutions you trust and afford
DM Consulting Services
Management, Human Resources, e-business, IT Solutions



duapune.com

PËRMBAJTJA:

Përschendetje.....	3
DM Consulting Services (DMCS) – www.dm-consulting.biz	4
The Network.....	5
duapune.com.....	6
Akademia e Burimeve Njerëzore	7
PROGRAMI.....	8
TRAJNERËT	8
Trajnimi – Njohuri të përgjithshme në Burime Njerëzore	9
Trajnimi – Rekrutimi dhe Përzgjedhja e punonjësve.....	10
Trajnimi – Menaxhimi i Performancës dhe Plani i zhvillimit.....	11
Trajnimi – Trajnimi dhe Zhvillimi i Punonjësve	12
Trajnimi – Menaxhimi i Kontratave të punës dhe Kodi Punës.....	13
Trajnimi – Ligji i të dhënave personale në fushën e punësimit.....	14
Pse duhet të regjistrohem?	16
Aneks: Trajnerët	17

Përshëndetje

Me mbi 20 vite përvojë, DM Consulting Services ka bashkëpunuar me kompani si në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për të siguruar ekspertizë të personalizuar të burimeve njerëzore për bizneset e të gjitha madhësive. DM Consulting Services ofron një gamë të gjerë shërbimesh për të përmbushur nevojat e burimeve njerëzore nga rekrutimi, përzgjedhja, trajnimi dhe përputhja e profileve të duhura me kandidatët e duhur, pavarësisht industrisë së cilës i përket biznesi.

Duke konsideruar njeriun si forcën kryesore për zhvillimin ekonomik të vendit dhe si lider në botën e inovacionit të burimeve njerëzore falë edhe bashkëpunimit prej shumë vitesh me të gjithë aktorët e rëndësishëm që kontribuojnë në mënyrë aktive në transformimin modern, dixhital dhe inovativ të rolit të BNJ, DM Consulting Services dhe duapune.com do të vijojnë me zhvillimin e aktiviteteve të kësaj rëndësie.

Ndaj kemi kënaqësinë të lançojmë për herë të parë në Shqipëri aktivitetin “Akademia e Burimeve Njerëzore”, një cikël trajnimesh, qëllimi i të cilave është informimi i punonjësve të Burimeve Njerëzore me eksperiencë që duan të rifreskojnë njohuritë dhe të njohin tendencat e fundit.

DM Consulting Services (DMCS) – www.dm-consulting.biz

DMCS është themeluar në vitin 2006 duke iu ofruar klientëve zgjidhje cilësore, të qëndrueshme, inovative, kosto efektive dhe kursim në kohë për shërbime biznesi dhe të teknologjisë së informacionit. Fushat kryesore ku ne operojmë konsistojnë në:

1. Konsulencë dhe zgjidhje në fushën e teknologjisë (Web, cloud computing dhe software application)
2. Menaxhim të Burimeve Njerëzore, rekrutime dhe trajnime
3. Shërbime Inteligjente të Tregut (Studim tregu, studime vizibiliteti, etj)

DM Consulting Services bën pjesë si anëtare e International Telecommunication and IT Consultants Network

(ITIC Group), një nga grupet lider në fushën e konsulencave në Europë. DMCS është e vendosur në Tiranë (Shqipëri), në Prishtinë (Kosovo) dhe me një prezencë të fortë në Maqedoni dhe Mal të Zi.

DMCS është gjithashtu një kompani lider për ofrimin e shërbimeve të konsulencës dhe zhvillimeve software në treg. DM Consulting Services është kompania e vetme në treg që kryen Analizën e Proçeseve të Biznesit (APB). Analiza e Proçeseve të Biznesit i shërben klientit për të përmirësuar ose ndryshuar në mënyre radikale proçeset e biznesit, me qëllim që të rrisin fitimin dhe të sigurojnë vazhdimësinë afatgjatë.

The Network

Suksesi i *The Network* bazohet në forcën e anëtarëve të tij. Të gjithë pjesëmarrësit kryesorë në vendet e tyre përkatëse, janë udhëheqës të qartë të tregut dhe madje disa zotërojnë mbi 80% të tregut. Në një mision për të siguruar rekrutuesit me një zgjidhje globale për të gjitha nevojat e tyre ndërkombëtare të punësimit, gjatë dekadës së fundit The Network është rritur në një anëtarësim të bordeve kryesore të punës në botë që mbulojnë 130+ vende. Duke bashkuar shërbimet më të mira lokale të rekrutimit në një zgjidhje të përshtatshme globale.

Disa filluan si klasifikime tradicionale me grupe të mëdha mediatike si Axel Springer dhe SaonGroup, ndërsa të tjerët po vendosin standarde për zgjidhjet e nesërme të rekrutimit në tregjet në rritje. DM Consulting Services bashkëpunon me The Network prej 10 vitesh tashmë.

duapune.com

duapune.com është platforma udhëheqëse e punës në internet në Shqipëri dhe Kosovë, e dedikuar 100% mundësive të punës dhe karrierës, që nga viti 2009. Vlerësohet si një nga portalet kryesore rajonale të punës.

Qëllimi kryesor i duapune.com është të ndihmojë punëdhënësit të punësojnë specialistë dhe punonjës duke përdorur teknologjinë më të përparuar.

Duapune.com numëron mbi 170.000 punëkërkues të regjistruar, mbi 13,000 punëdhënës dhe një komunitet online prej 500,000 ndjekës të shpërndarë në Facebook, LinkedIn dhe në platforma të tjera të mediave sociale.

Përfaqëson një nga pionerët e shërbimeve online dhe ka një markë unike të respektuar për tregun e punës në Shqipëri dhe Kosovë, duke i shërbyer një popullsie prej 6-7 milion.

Përveç shërbimeve të punës, ky portal ofron gjithashtu edhe shërbime të ndërtimit dhe zhvillimit të karrierës. Shumë artikuj të fokusuar në zhvillimin e suksesshëm të karrierës dhe në trajnime të dobishme postohen në portal në mënyrë të vazhdueshme. Kjo u jep mundësi shumë përdoruesve të zgjerojnë potencialin e tyre dhe të bëhen më konkurrues.

Platforma mbështetet dhe stimulohet nga një bazë të dhënash e pasur me informata për punëkërkuesit, punëdhënësit, vendet e lira të punës, postimet e punës dhe kështu me radhë.

Duapune.com gjeneron në mënyrë të vazhdueshme Indeks të Punësimit, si dhe një gazetë online për punë. Ka një llogaritëse pagash dhe mjete të tjera të nevojshme që përdoren në platformë.

Aktualisht duapune.com vepron në versionin 9.0.

Akademia e Burimeve Njerëzore

Kush mund të marri pjesë në trajnimet tona?

Specialistët e rinj të BNJ

Të rinjtë që duan të specializohen në fushën e BNJ

Profesionistë

Qëllimi i këtyre trajnimeve është informimi i punonjësve të Burimeve Njerëzore me eksperiencë që duan të rifreskojnë njohuritë dhe të njohin tendencat e fundit si dhe studentëve të burimeve njerëzore të cilët duan të marrin njohuri më të thelluara. Punonjës me eksperiencë në BNJ në një profil të caktuar që duan të zhvillohen në të gjitha disiplinat e BNJ. Janë të ftuar Asistente Administrative / Ekzekutive që planifikojnë të rriten në karrierë në fushën e BNJ dhe të zhvillohen më tej në karrierën e tyre dhe studentë të sapo diplomuar në burime njerëzore të cilët janë të interesuar të marrin më shumë njohuri.

Në këto trajnime do të mësoni rreth praktikave dhe procedurave të përdorura në departamentet e Burimeve Njerëzore të ditëve të sotme. Trajnimet nënvijëzojnë proceset që profesionistët e BNJ ndërmarrin për të bërë të mundur që të kenë punonjësit e duhur në kohën e duhur me qëllim që kompania të jetë dhe produktive dhe fitimprurëse.

Në modulet tona të trajnimeve shpjegohen me detaje rolet kryesore që Departamentet e BNJ luajnë në një kompani dhe sesi në një botë që ndryshon vazhdimisht dhe me ritëm të shpejtë, funksionet e BNJ janë çelësi i suksesit. Gjithashtu do mësoni mbi setin e aftësive të nevojshme për t'u ballafaquar me një sërë situatash në BNJ dhe sfidat që në ditët e sotme menaxhimi i burimeve njerëzore kalon.

PROGRAMI

Ky cikël trajnimesh përbëhet nga 6 trajnime me tematikat si në vijim:

1. Njohuri të përgjithshme në Burime Njerëzore
2. Rekrutimi dhe Përzgjedhja e punonjësve
3. Menaxhimi i Kontratave të punës dhe Kodi i Punës
4. Menaxhimi i Performancës dhe plani i zhvillimit
5. Trajnimi dhe Zhvillimi i Punonjësve
6. Ligji i të dhënave personale në fushën e punësimit

TRAJNERËT

Trajnerët tanë janë ekspertë të burimeve njerëzore me eksperiencë si trajnierë por edhe Drejtues ose ekspertë të burimeve njerëzore prej vitesh në kompani të mirënjohura Shqiptare dhe jo vetëm.

Logjistika:

Në klasë

Cdo të premte ora 14:00

Çdo trajnim nuk do të ketë më shumë se 15 veta

Kohëzgjatja për secilin trajnim do të jetë 4 orë

Çdo pjesëmarrës do të ketë akses online për materialet e trajnimeve

Trajnimet do të përmbajnë leksion (prezantim), shembuj nga aktivitetet e burimeve njerëzore, ushtrime, video.

Në përfundim të trajnimeve pjesëmarrësit që kanë frekuentuar do të pajisen me një certifikatë nga duapune.com.

Trajnimi – Njohuri të përgjithshme në Burime Njerëzore

ZHVILLIMI I TRAJNIMIT

Pas pjesëmarrjes në këtë trajnim do jeni të aftë të praktikoni lehtësisht njohuritë e marra gjatë trajnimit pasi dhe tematika shtjellohen në mënyrë shumë praktike dhe të kuptueshme.

Tematikat kryesore që do ofrohen në trajnim janë si në vijim:

- Inventari i aftësive
- Analiza e punëve dhe kompetencave
- Profilet e kandidatëve dhe aftësitë
- Gjetja e kandidatëve të duhur
- Zhvillimi i Intervistave
- Trajnimi i punonjësve
- Vlerësimi i performances
- Kompensimi dhe Benefitet
- Shëndeti dhe Siguria në punë
- Ligji i te dhenave personale ne biznes
- Dokumentacioni per trajnimin i te gjithë stafit me parashikimet e reja ligjore qe impaktojne biznesin;
- Politika Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale;

Trajnimi – Rekrutimi dhe Përzgjedhja e punonjësve

ZHVILLIMI I TRAJNIMIT

Pas pjesëmarrjes në këtë trajnim do jeni të aftë të praktikoni lehtësisht njohuritë e marra gjatë trajnimit pasi dhe tematika shtjellohen në mënyrë shumë praktike dhe të kuptueshme.

Tematikat kryesore që do ofrohen në trajnim janë si në vijim:

- Planifikimi i nevojave të stafit
- Cikli i Rekrutimit dhe Përzgjedhjes
- Leximi dhe analizimi i CV
- Burimet e Rekrutimit
- Mënyrat e publikimit të njoftimeve
- Tipet e Intervistave
- Tipet e Testimeve
- Rekrutimi i brendshëm/i jashtëm
- Specifikat e pozicioneve të ndryshme
- Dhënia e përgjigjeve për kandidatët
- Gjetja e njerëzve të duhur
- Rekrutimi i niveleve menaxheriale

Trajnimi – Menaxhimi i Performancës dhe Plani i zhvillimit

ZHVILLIMI I TRAJNIMIT

Pas pjesëmarrjes në këtë trajnim do jeni të aftë të praktikoni lehtësisht njohuritë e marra gjatë trajnimit pasi dhe tematika shtjellohen në mënyrë shumë praktike dhe të kuptueshme.

Tematikat kryesore që do ofrohen në trajnim janë si në vijim:

- Sistemi i performancës
- Elementet kryesore të performancës
- Përcaktimi i indikatoreve të performancës
- Komponentët e menaxhimit të performancës
- Politika e menaxhimit të performancës
- Guida e zhvillimit të një sistemi performance
- Incentivat dhe skemat e vlerësimit
- Benefitet e performancës
- Roli i menaxherëve dhe punonjësve
- Plani i Komunikimit
- Menaxhimi i procesit
- Ballafaqimi me mos-dakortësinë
- Plani i përmirësimit

Trajnimi – Trajnimi dhe Zhvillimi i Punonjësve

ZHVILLIMI I TRAJNIMIT

Pas pjesëmarrjes në këtë trajnim do jeni të aftë të praktikoni lehtësisht njohuritë e marra gjatë trajnimit pasi dhe tematika shtjellohen në mënyrë shumë praktike dhe të kuptueshme.

Tematikat kryesore që do ofrohen në trajnim janë si në vijim:

- Roli i trajnimeve në kompani
- Benefitet e trajnimit dhe zhvillimit
- Identifikimi i Nevojave të Trajnimeve
- Roli i BNJ në ofrimin e trajnimeve
- Vlerësimi i Trajnimit
- Menaxhimi i Trajnimit dhe Zhvillimit
- Dizenjimi i trajnimeve
- Metodatat e trajnimit
- Llojet e trajnimeve
- Kriteret për përzgjedhjen e ofruesve të trajnimit
- Zhvillimi i Punonjësve dhe potencialeve
- Trajnimet e brendshme / Trajnimet e jashtme
- Monitorimi, testimi dhe vlerësimi i potencialeve
- Zhvillimi i karrierës dhe potencialeve

Trajnimi – Menaxhimi i Kontratave të punës dhe Kodi Punës

ZHVILLIMI I TRAJNIMIT

Pas pjesëmarrjes në këtë trajnim do jeni të aftë të praktikoni lehtësisht njohuritë e marra gjatë trajnimit pasi dhe tematika shtjellohen në mënyrë shumë praktike dhe të kuptueshme.

Tematikat kryesore që do ofrohen në trajnim janë si në vijim:

- Kodi i Punës Shqiptar
- Ndryshimet e fundit Tipet e kontratave
- Kontratat me kohë të pjesshme dhe të plotë
- Marrëdhëniet e punësimit
- Informacion i nevojshëm në një kontratë punësimi
- Mbrojtja e të dhënave
- Shëndeti dhe Siguria në punë
- Mbarimi i marrëdhënieve, Dorëheqja dhe Kontrata e mirëkuptimit
- Sindikatat dhe të drejtat e tyre
- Diskriminimi i punonjësve
- Mbrojtja e grave gjatë shtatëzansë dhe lejes së lindjes
- Privatësia, diskriminimi dhembrojtja e të dhënave
- Kontrata Per Ruajtjen e Konfidencialitetit;
- Kontrata e Kodit te Etikes;
- Manuali te Burimeve Njerezore ku parashikohen detyrime qe te mos nxjerrin informacionet personale te klienteve te biznesit;
- Njoftimet Zyrtare per Perpunimin e te Dhenave Personale, prane Komisionerit Per Mbrojtjen te Dhenave Personale.

Trajnimi – Ligji i të dhënave personale në fushën e punësimit

ZHVILLIMI I TRAJNIMIT

Pas pjesëmarrjes në këtë trajnim do jeni të aftë të praktikoni lehtësisht njohuritë e marra gjatë trajnimit pasi dhe tematika shtjellohen në mënyrë shumë praktike dhe të kuptueshme.


Tematikat kryesore që do ofrohen në trajnim janë si në vijim:

- Prezantimi i Ndryshimeve Ligjore Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale qe Impaktojne Biznesin.
- Shpjegime mbi termat e reja te Ligjit.
- Risite e Rregullores se Komisionit Evropian
- Prezantim Politikes Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale;
- Impakti ne Kontratat e Punes per punonjesit;
- Shpjegime Per Ruajtjen e Konfidencialitetit;
- Prezantim i Kodit te Etikes;
- Rishikim i Manualit te Burimeve Njerezore (ku do te parashikohen detyrime per te gjithë punonjesit qe te mosekspozojne informacionet personale te klienteve te biznesit);
- Punonjesi qe do te ngarkohet me detyren e Nepunesit Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale ne Biznes.
- Njohja e pergatitja e Njoftimit Zyrtar per Perpunimin e te Dhenave Personale, prane Komisionerit Per Mbrojtjen te Dhenave Personale;

HR *academy*



Solutions you trust and afford
DM Consulting Services
Management, Human Resources, e-business, IT Solutions



Pse duhet të regjistrohem?

85% e vendeve të punës pritet të rikrijohen deri në vitin 2030. Për të qëndruar të rëndësishëm në tregun e punës kërkohen aftësi, mendësi dhe sjellje të reja nga Burimet Njerëzore dhe fuqia jonë e punës. Deri në fund të këtij programi, ju jeni një Specialist HR me aftësitë për të udhëhequr me sukses departamentin e BNJ dhe për të siguruar që kompania ose biznesi juaj nuk do të mbetet pas. Trajnimet për BNJ ju ndihmojnë në zhvillimin e një kuptimi më të thellë të sjelljes organizative dhe psikologjisë së punonjësve.

Megjithatë, janë të shumta organizatat apo kompanitë që nuk kanë një qasje sistematike ndaj zhvillimit të aftësive të ekipit të BNJ.

Akademia e Burimeve Njerëzore është një zgjidhje gjithëpërfshirëse e të mësuarit, e dizajnuar për të ndërtuar aftësi. Duke u bërë pjesë e këtij cikli trajnimesh ju do të keni mundësi të rifreskoni dhe përditësoni dijet tuaja në BNJ, apo të merrni njohuritë e nevojshme dhe të rëndësishme për të zhvilluar më tej karrierën tuaj në këtë fushë. Qëllimi ynë është maksimizimi i vlerave që çdo punonjës përcjell tek kompanitë respektive dhe rritja e produktivitetit në biznes.

Në mënyrë që të bëhemi fuqia strategjike që duhet të jetë HR, ne kemi nevojë për një brez të ri drejtuesish të BNJ. Për t'u bërë me ndikim, drejtuesit e sotëm të BNJ kanë nevojë për informacion të përditësuar, një kuptim të plotë të parimeve të dizajnit organizativ dhe të efektivitetit të modeleve të ndryshme të funksionimit të burimeve njerëzore.



Kurset e ofruara:

- Njohuri të përgjithshme në Burime Njerëzore
- Rekrutimi dhe Përzgjedhja e punonjësve
- Menaxhimi i Performancës dhe plani i zhvillimit
- Trajnimi dhe Zhvillimi i Punonjësve

Vojsava Gjergaj

BIO E TRAJNERIT

Vojsava Gjergaj ka një ekperiencë shumëvjeçare si eksperte e BNJ.

Prej 9 vjetësh është përqëndruar në Menaxhimin e Burimeve Njerëzore duke fituar përvojë kombëtare dhe ndërkombëtare duke punuar si me biznese vendase, ndërkombëtare dhe me NGO. Ka punuar si menaxhere e burimeve njerëzore tek Coca Cola ne Shqiperi. Ka një eksperiencë 4 mujore si konsultente burimesh njerëzore ne Egjipt dhe tre vjet menaxhere BNJ tek plan International ndërkombëtare. Prej disa vitesh Menaxhere e Burimeve Njerëzore për një nga kompanitë prodhuese më të mëdhaja në Shqipëri si dhe trajnuese në BNJ në projekte të EU për SME-të.



Kursi i ofruar:

- Menaxhimi i Kontratave të punës dhe Kodi i Punë

Zyhrada Kongoli

BIO E TRAJNERIT

Zyhrada Kongoli është eksperte ligjore Shqiptare e cila ka një përvojë të gjatë profesionale prej 23 vitesh, në sektorin publik dhe privat. Gjatë përvojës së saj profesionale prej 13 vjetësh si eksperte e pavarur juridike, ajo ofron ekspertizë dhe këshillim për projekte, programe dhe klientë të tjerë për çdo lloj çështje ligjore në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e legjislacionit shqiptar dhe rregulloreve të tij zbatuese.

Zonja Kongoli ka qenë e angazhuar me projekte dhe programe të ndryshme për të zhvilluar analizën e boshllëkut ligjor në fushat e sipërpërmendura dhe ka ndihmuar Ministritë përgjegjëse në përafrimin e legjislacionit Shqiptar



Kurset e ofruara:

- Njohuri të përgjithshme në Burime Njerëzore
- Rekrutimi dhe Përzgjedhja e punonjësve

Eljana Mete

BIO E TRAJNERIT

Eljana Mete ka më shumë se 12 vite përvojë në industrinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Rekrutimit . Ajo është bashkëthemeluese e platformës së parë digjitale të punësimit në Shqipëri: duapune.com.

Ajo çfarë e dallon Eljanën, duke e bërë një nga profesionistet më të rëndësishme në industrinë e Burimeve Njerëzore dhe Rekrutimit, është se ka arritur të gjejë një balancë të shkëlqyer mes fushës së saj të studimeve në Psikologji dhe Pedagogji nga Universiteti i Montreal në Kanada dhe eksperiencës së fituar nëpërmjet përdorimit të teknologjisë gjatë procesit të rekrutimit dhe selektimit të Burimeve Njerëzore për kompani të ndryshme.



Kurset e ofruara:

- Njohuri të përgjithshme në Burime Njerëzore
- Rekrutimi dhe Përzgjedhja e punonjësve
- Menaxhimi i Performancës dhe plani i zhvillimit
- Trajnimi dhe Zhvillimi i Punonjësve

Rajmonda Mulaj

BIO E TRAJNERIT

Ka përfunduar studimet në Fakultetin e Shkencave Sociale, dega Punë Sociale, në vitin 2006, ndërsa në të njëjtin fakultet ka përfunduar edhe Masterin Shkencor me temën "Hartim dhe zbatim i politikave sociale".

Me një eksperiencë mbi 16-vjeçare pranë Zyrës së Punës në Tiranë, ajo ka ushtruar funksionin e Specialistes së Punësimit, ku ka qenë e angazhuar në një gamë të gjerë detyrash që përfshinin: identifikimin e kërkesës për vende pune në treg, vlerësimin e aftësive të personave të papunë për t'u përfshirë në tregun e punës apo në skemat sociale të punësimit dhe të trajnimit.

Aktualisht, Rajmonda Mulaj ushtron detyrën e Inspektore në Sektorin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë pranë Drejtorisë Qendrore të Inspektoratit të Punës. Fokusi i saj kryesor është përmirësimi i kushteve dhe marrëdhënieve të punës midis punëdhënësve dhe punëmarrësve.

Ekspertiza e saj përfshin identifikimin dhe rekrutimin, komunikimin profesional, vlerësimin e nevojave të tregut të punës, si dhe përmirësimin e marrëdhënieve të punës përmes njohjes dhe zbatimit të legjislacionit të punës në Shqipëri.



Kursi i ofruar:

- Ligji i të dhënave personale në fushën e punësimit

Rezana Balla

BIO E TRAJNERIT

Juriste biznesi me 29 vite përvojë, që këshillon mbi të gjitha aspektet e së drejtës së biznesit, duke përfshirë korporatat, qeverisjen, punësimin, tatimet, bashkimet ligjore, implikimet e ligjit të konkurrencës, mbrojtjen e të dhënave, pronësinë intelektuale, sinjalizimin etj. Si jurist biznesi jam fokusuar gjithashtu në procese gjyqësore dhe zgjidhje alternative të mosmarrëveshjeve, duke përfaqësuar klientë kombëtarë dhe ndërkombëtarë në të gjitha nivelet e gjykatave, në çështje kryesisht të lidhura me pasuritë e paluajtshme, tatimet, punësimin, mosmarrëveshjet civile dhe çdo lloj tjetër mosmarrëveshjes tregtare-korporative.

Gjatë përvojës profesionale, ka mbajtur edhe pozicione drejtuese në kompani ndërkombëtare, duke marrë përgjegjësinë për ofrimin e këshillave ligjore gjithëpërfshirëse, të thelluara dhe të orientuara drejt biznesit për të gjitha çështjet ligjore të kompanive si dhe ekspertize mbi ligjin e ri të mbrojtjes e të dhënave personale.



Kursi i ofruar:

- Ligji i të dhënave personale në fushën e punësimit

Alketa Elezi

BIO E TRAJNERIT

Avokatja Alketa Elezi ka ndërtuar një karrierë të spikatur përmes përfaqësimit të saj të gjerë dhe të suksesshëm në seanca gjyqësore, duke arritur rezultate të rëndësishme në mbrojtjen e interesave të klientëve. Ajo njihet për profesionalizmin dhe qasjen e saj objektive, duke theksuar se një vendim i pafavorshëm nuk lidhet domosdoshmërisht me dështimin e mbrojtjes, por shpesh me kompleksitetin e çështjes, rrethanat konkrete të objektit gjyqësor, dinamikën e palëve të përfshira dhe vendimmarrjen e trupës gjyqësore.

Eksperienca e saj e gjerë në një numër të konsiderueshëm procesesh gjyqësore reflekton një profil të pasur profesional, i cili ndërtohet mbi një nivel të lartë kualifikimi akademik dhe përkushtim të vazhdueshëm ndaj literaturës juridike. Kombinimi i këtyre elementeve me këmbënguljen dhe integritetin profesional përbën themelin e suksesit të saj.

Përveç praktikës gjyqësore, Avokatja Elezi ushtron ekspertizë pranë bizneseve në fushën e legjislacionit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale, duke ofruar mbështetje dhe këshillim të specializuar për zbatimin efektiv të tij.



Kurset e ofruara:

- Njohuri të përgjithshme në Burime Njerëzore
- Rekrutimi dhe Përzgjedhja e punonjësve
- Menaxhimi i Performancës dhe plani i zhvillimit
- Trajnimi dhe Zhvillimi i Punonjësve

Anjeza Kelmendi

BIO E TRAJNERIT

Me mbi një dekadë përvojë në drejtimin e Burimeve Njerëzore, Anjeza është e specializuar në rekrutimin ekzekutiv, strategjinë e HR dhe zhvillimin organizativ. Ajo ka një histori të suksesshme në hartimin dhe zbatimin e programeve inovative për menaxhimin e talenteve dhe zhvillimin e punonjësve, duke rritur efektivitetin organizativ. Si Këshilltare dhe Trajnere HR, Anjeza ka udhëhequr procese kërkimi ekzekutiv, ka trajnuar ekipe drejtuesish dhe ka zbatuar plane pasardhjeje e sisteme të menaxhimit të performancës që kanë sjellë rezultate konkrete biznesi.

Anjeza shquhet për aftësinë për të menaxhuar mjedise komplekse, duke drejtuar operacione të mëdha HR dhe duke orientuar organizatat gjatë ndryshimeve me vizion strategjik. Qoftë në krijimin e strukturave të kompensimit për 5,000 punonjës në shtatë vende apo në zhvillimin e trajnimeve me ndikim të lartë, ajo siguron që funksionet e HR të mbështesin dhe të forcojnë objektivat e kompanisë. Forca e saj qëndron në balancimin e përputhshmërisë me inovacionin, në përcaktimin e prioriteteve dhe në ndërtimin e një kulture pune pozitive që rrit angazhimin dhe qëndrueshmërinë e punonjësve.



Kurset e ofruara:

- Njohuri të përgjithshme në Burime Njerëzore
- Rekrutimi dhe Përzgjedhja e punonjësve
- Menaxhimi i Performancës dhe plani i zhvillimit
- Trajnimi dhe Zhvillimi i Punonjësve

Elda Bajraktari

BIO E TRAJNERIT

Me mbi 25 vjet përvojë profesionale në organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, institucione qeveritare dhe sektorin privat, ajo ka ndërtuar një karrierë të bazuar në tre shtylla kryesore: Burimet Njerëzore, Administrimi & Operacionet, dhe Koordinimi i Projekteve. Rruga e saj profesionale pasqyron një përkushtim të thellë ndaj ekselencës organizative, zhvillimit të njerëzve dhe ndikimit strategjik.

Ajo ka kaluar më shumë se 15 vjet në role udhëheqëse të larta në HR, duke menaxhuar funksione komplekse të HR-së për organizata me deri në 400 punonjës dhe duke mbikëqyrur buxhete HR me vlera shumë milion-euro. Puna e saj ka qenë e përqendruar në zhvillimin dhe implementimin e sistemeve për rekrutimin e talenteve, angazhimin dhe mbajtjen e punonjësve, menaxhimin e talenteve, të nxënies & zhvillimit, kompensimet & përfitimet dhe vlerësimin e performancës—gjithnjë duke siguruar përputhshmëri të plotë ligjore dhe duke kultivuar kultura pune gjithëpërfshirëse.



Kurset e ofruara:

- Njohuri të përgjithshme në Burime Njerëzore
- Rekrutimi dhe Përzgjedhja e punonjësve
- Menaxhimi i Performancës dhe plani i zhvillimit
- Trajnimi dhe Zhvillimi i Punonjësve

Migena Qyra

BIO E TRAJNERIT

Si Menaxhere e Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Organizimit, kompetencat e saj kryesore përfshijnë drejtimin e departamentit të HR-së, hartimin e strategjisë së HR-së, organizimin e brendshëm, menaxhimin dhe zgjidhjen e konflikteve, ndërtimin e bashkëpunimit në ekip, trajnimin, negociatat, menaxhimin, marketingun, menaxhimin e rrjeteve sociale, kujdesin ndaj klientit, si dhe menaxhimin e rrezikut financiar dhe të përgjithshëm.

Në përvojën e saj, ajo ka punuar me ekipe të ndryshme dhe dinamike për të ofruar zgjidhje inovative dhe efektive për klientët në industrinë e prodhimit, tregtinë me pakicë dhe sektorin bankar. Ajo ka mbi 8 vjet përvojë në menaxhimin dhe transformimin e HR-së.

Është një trajner profesionist i fortë, gjithmonë e etur për të mësuar, për të arritur objektiva të reja dhe për të përballuar sfida të reja. Ajo i pëlqen të ndihmojë kompanitë gjatë proceseve të rëndësishme të transformimit dhe rritjes, dhe ka pasion për krijimin e një ambienti pune pozitiv dhe produktiv për të gjithë.